



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 12.07.2019

RAPORT

PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 166, DATË 16.12.2004 “RREGULLORJA E KUVENDIT TË SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR”

I. Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*Komisioni*), në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 30.01.2019, 6.2.2019, 15.05.2019, 22.05.2019, 10.07.2019, 11.07.2019 dhe 12.07.2019 mori në shqyrtim projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 166, datë 16.12.2004 “Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë” të ndryshuar”, nismë e grupit parlamentar të Partisë Socialiste (PS) e depozituar në Kuvend më 12.01.2018.

Komisioni mori atributin e komisionit përgjegjës në bazë të vendimeve nr. 117 dhe nr. 118, datë 22.11.2018 të Kuvendit “Për miratimin e programit të punës për periudhën 3-28 Dhjetor” dhe “Për miratimin e kalendarit tre javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 3-21 Dhjetor 2018”. Për shqyrtimin e këtij projektvendimi, Komisioni caktoi relatore deputeten Vasilika Hysi.

Propozimet për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit u paraqitën në mbledhjet e komisionit nga kryetari i grupit parlamentar të PS-së z. Taulant Balla, në cilësinë e nismëtarit.

II. BAZA LIGJORE E PROPOZIMEVE PËR NDRYSHIME NË RREGULLOREN E KUVENDIT

Projektvendimi i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga grupi parlamentar i Partisë Socialiste, sipas përcaktimeve të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit sipas së cilës “*Çdo deputet ka të drejtë të paraqesë propozime për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit. Për shqyrtimin e këtyre propozimeve ndiqet procedura e parashikuar në këtë Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e projektligjeve. Ndryshimet në këtë Rregullore miratohen me*

shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit dhe është shoqëruar me relacionin sipas përcaktimit të nenit 68 të Rregullores”.

III. HISTORIKU I NDRYSHIMEVETË RREGULLORES SË KUVENDIT

Rregullorja e Kuvendit është miratuar me vendim nr. 166, datë 16.12.2004 të Kuvendit të Shqipërisë, me konsensusin e të gjitha forcave politike në Kuvend, pas një procesi të gjatë pune për hartimin e saj nga një grup pune me deputetë nga të gjitha grupet parlamentare, asistuar nga Prezenca e OSBE-së në Tiranë nëpërmjet projektit të saj për forcimin e kapaciteteve të Kuvendit.

Rregullorja e Kuvendit u është nënshtruar disa ndryshimeve në periudha të ndryshme¹. Ndryshimet kanë qenë:

- shumë të shpejta (pa proces konsultimi) dhe nuk janë votuar me konsensus (rastet e ndryshimeve të vitit 2005, vendimi nr. 15/2005; të vitit 2010, vendimet nr. 21/2010 dhe 41/2010; të vitit 2011, vendimi nr. 88/2011);
- me konsensus të forcave kryesore parlamentare në Kuvend, të hartuara me grup pune dhe me ekspertizë mbi bazën e përvojave ndërkombëtare të Parlamentit Europian dhe të parlamenteve të vendeve anëtare të BE-së (ndryshimet e vitit 2013, vendimi nr. 41/2013);
- me mirëkuptim, ndryshime të natyrës organizative (vendimet 95/2014 dhe 88/2017).

Rregullorja në fuqi ka rreth 15 vjet që zbatohet dhe ka krijuar një traditë në praktikën parlamentare. Gjatë kësaj periudhe, roli i Kuvendit në çështjet e integritetit evropian është rritur, funksioni i kontrollit parlamentar është zgjeruar; institucionet ndërkombëtare në raportet e tyre kanë adresuar disa rekomandime për rritjen e transparencës së veprimtarisë së Kuvendit dhe të pjesëmarrjes së publikut në vendimarrje; një sërë rezolutash ndërkombëtare rekomandojnë rritjen e angazhimit të parlamentarëve në adresimin e çështjeve me interes publik; vlerësimet e veprimtarisë së shërbimeve të Kuvendit kanë vënë në dukje nevojën për përmirësime në Rregullore. Rregullorja nuk reflektonte ndryshimet e bëra në Kushtetutë në vitin 2016 lidhur me kufizimin e imunitetit të deputetit nga ndjekja penale.

IV. HISTORIKU I SHQYRTIMIT TË PROJEKTVENDIMIT “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 166, DATË 16.12.2004 “RREGULLORJA E KUVENDIT TË SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR”

1. Rregullorja e Kuvendit e miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004:

- ndryshuar me vendimin nr. 15, datë 27.12.2005;
- ndryshuar me vendimin nr. 193, datë 07.07.2008;
- ndryshuar me vendimin nr. 21, datë 04.03.2010;
- ndryshuar me vendimin nr. 41, datë 24.06.2010;
- ndryshuar me vendimin nr. 88, datë 24.02.2011;
- ndryshuar me vendimin nr. 41/2013 datë 30.05.2013;
- ndryshuar me vendimin nr. 95/2014 datë 27.11.2014;
- ndryshuar me vendimin nr. 88/2017, datë 14.9.2017.

Projektvendimi, u diskutua fillimisht në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, si organi përgjegjës që në mbështetje të nenit 13 të Rregullores së Kuvendit studioi propozimet për ndryshimin e Rregullores. Më 19 janar 2018 Këshilli zhvilloi mbledhjen e tij të parë (dhe të fundit) për tu njohur me projektvendimin e paraqitur nga deputetët. Këshilli ngriti një grup pune me deputetë, përfaqësues të të gjitha grupeve parlamentare për të dakortësuar lidhur me dy çështje, konkretisht për draftin e Kodit të Sjelljes si dhe projektvendimin në fjalë. Të dyja këto çështje shqyrtoheshin njëkohësisht.

Deri në prill 2018, grupi i punës arriti të hartojë një projekt i cili përmbante propozimet fillestare të depozituara në Kuvend më 12.1.2018, propozimet e grupit parlamentar të Partisë Demokratike që konsistonin në një rishikim tërësor të kreut VI të Rregullores “Rregulli dhe sjellja në Kuvend”, propozimet për zhvillimin e veprimtarisë parlamentare si dhe disa propozime të Shërbimeve të Kuvendit.

Pas muajit prill 2018, grupi i punës nuk arriti të mblidhej më dhe puna e tij u ndërpre. Veprimtaria e Këshillit u bllokua si rezultat i mosmarrjes pjesë të opozitës parlamentare në punimet e Kuvendit. Për pasojë, sesioni i dytë parlamentar (janar-korrik 2018) u mbyll pa bërë të mundur miratimin e propozimeve për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit.

Ndërkohë, Komisioni European në progres raportin për Shqipërinë 2018², ekspertët e projektit të binjakëzimit IPA të Bashkimit European në Kuvend dhe GRECO (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit)³, strukturë e Këshillit të Europës, rekomanduan ndryshime në Rregulloren e Kuvendit. Nisur nga kjo, Konferenca e Kryetarëve i kërkoi grupit të punës dhe shërbimeve të Kuvendit adresimin dhe përfshirjen e të gjitha rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarëve në projektin e hartuar.

Shërbimet e Kuvendit, për sa më sipër, reflektuan rekomandimet e ndërkombëtarëve të cilat konsistonin në drejtimitet e mëposhtme:

- a) Reflektimin e ligjit nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian” në dispozitate Rregulloresë Kuvendit për procesin e integritetit evropian;
- b) 25 rekomandime të ekspertëve të BE-së në kuadër të zbatimit të Projektit të Binjakëzimit “*Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE*”, në kuadër të IPA 2014 për Shqipërinë, konkretisht:
 - për komponentin e parë - 3 rekomandime të reflektuara;
 - për komponentin e dytë - 15 rekomandime të reflektuara;
 - për komponentin e tretë - 2 rekomandime të reflektuara në Rregullore (dhe projektligji i përgatitur për pavarësinë buxhetore);

² Raporti i Progresit për Shqipërinë: EU, 2018, fq.9-10. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

³ Parandalimi i krimit në lidhje me anëtarët e parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët, Raundi i katërt i vlerësimit, raporti i dytë i përputhshmërisë. Ky raport gjendet i botuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë: <https://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2018/07/GRECO.pdf>

- për komponentin e katërt - 5 rekomandime të reflektuara;
- c) Rekomandimet e GRECO-s për përputhjen e Rregullores së Kuvendit me Kodin e Sjelljes, lidhur me vendosjen e referencave në Rregulloren e Kuvendit tek masat respektive disiplinore në rastin e shkeljeve të parashikuara të Kodit të Sjelljes së Deputetit, përputhjen e Rregullores së Kuvendit me Kodin e Sjelljes dhe parashikimin e së drejtës për ankim ndaj vendimeve për masa disiplinore.

Më 15 tetor 2018, propozimet për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit, u vendosën në dispozicion të të gjitha grupeve parlamentare për të paraqitur propozimet e tyre për përmirësime të mëtejshme, me qëllim arritjen e dakortësisë midis të gjitha forcave politike në Kuvend.

Gjatë sesionit të tretë, (shtator-dhjetor 2018), opozita parlamentare nuk mori pjesë në punimet e Kuvendit dhe organet e tij. Për pasojë, veprimtaria e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin vijoi të mbetej e bllokuar. Në këto kushte, për të zhbllokuar shqyrtimin e ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit, Konferenca e Kryetarëve, në mbledhjen e datës 22 nëntor 2018, referuar edhe praktikës së mëparshme parlamentare, propozoi komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si organ përgjegjës për shqyrtimin e këtyre propozimeve.

Me vendimin nr. 117, datë 22.11.2018, Kuvendi miratoi Programin e punës për periudhën 3-28 Dhjetor 2018 dhe me vendimin nr. 118 datë 22.11.2018, Kalendarin tre javor të punimeve për periudhën 3-21 dhjetor 2018, ku atributi për shqyrtimin e ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit përfundimisht iu caktua Komisionit për Çështje Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Kalendarin 3 javor përcakttoi datën 20 dhjetor 2018 si datë për shqyrtimin dhe miratimin e propozimeve në seancë plenare. Me kërkesë të opozitës parlamentare, shqyrtimi i propozimeve për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit u shty për në Janar 2019.

Që prej fillimit të sesionit të IV parlamentar, propozimet për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit u përfshinë në të gjitha programet e punës dhe kalendarët tre javore vijuese të Kuvendit. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut zhvilloi më datat 30 janar dhe 6 shkurt 2019 mbledhjet e parashikuara për këtë qëllim.

Projekti i hartuar përmbante propozimet e grupit parlamentar të PS-së të depozituara më 12.1.2018, propozime të ish grupit parlamentar të PD-së, reflektimet e rekomandimeve të ndërkombëtarëve, të rezolutës së Kuvendit për axhendën 2030 të Kombeve të Bashkuara për zhvillimin e qëndrueshëm, të Kodit Zgjedhor si dhe propozime të shërbimeve të Kuvendit.

Përfaqësuesit e opozitës parlamentare në komision, (*ish grupi parlamentar i PD-së dhe LSI-së*), në aspektin procedural, u shprehën kundër shqyrtimit të tyre në Komisionin e Ligjeve me arsyetimin se struktura përgjegjëse për shqyrtim ishte Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, edhe pse për një pjesë të ndryshimeve ishin dakord, veçanërisht për reflektimin e rekomandimeve të IPS-s, GRECO-s etj. Në lidhje me përmbajtjen e ndryshimeve, përfaqësuesit

në fjalë u shprehën kundër në parim vetëm për ndryshimin e propozuar nga PS në nenet 118 dhe 119 të Rregullores, të cilat trajtojnë çështjen e procedurës së imunitetit të deputetit.

Më datë 21.02.2019, deputetët e opozitës parlamentare deklaruan dorëheqjen nga mandati i deputetit. Për pasojë puna për shqyrtimin e propozimeve në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut u ndërpre për të rifilluar më datë 15.05.2019. Komisioni përfundoi shqyrtimin në tërësi të projektvendimit më 12.07.2019.

V. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT E TIJ

Kuvendi luan rolin kryesor në jetën politike të vendit dhe për pasojë rregullat mbi të cilat ai organizohet dhe funksionon duhet t'i përgjigjen dinamikës së kohës dhe procesit të avancuar të integritetit evropian të Shqipërisë. Tashmë Kuvendi ka krijuar përvojën e tij që duhet të mbahet mirë parasysh në përmirësimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij, natyrisht duke u ballafaquar edhe me praktikën e parlamenteve të vendeve të tjera, sidomos atyre të Bashkimit Evropian, si dhe me precedentët e mirë të krijuar deri më sot.

Komisioni Evropian në progres raportin për Shqipërinë, për vitin 2018 thekson nevojën për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit. Ndryshimet kushtetuese në lidhje me kufizimin e imunitetit dhe reformën në drejtësi, zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, rekomandimet e organizmave të tjerë ndërkombëtarë adresuar Kuvendit si dhe rekomandime nga shoqëria civile ose deputetë të pavarur sollën domosdoshmërinë e përmirësimit të Rregullores së Kuvendit. Nevoja për përmirësime, plotësime dhe përputhshmërie me vendimet e Gjykatave Kushtetuese dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë së ndryshuar përbënte domosdoshmëri.

Ndryshimet e propozuara synojnë të përmirësojnë ndjeshëm dispozitat e Rregullores së Kuvendit me qëllim sjelljen e saj në përputhje me standartet më të larta të demokracisë parlamentare dhe modeleve më të përparuara ndërkombëtare, në bashkëpunim me të gjitha forcat politike që përfaqësohen në Kuvend. Në mënyrë të posaçme, reflektohen ndryshimet kushtetuese të vitit 2012 në lidhje me kufizimin e imunitetit të deputetit si dhe jurisprudencën kushtetuese për përcaktimin e kuorumit të votimit dhe shumicës në vendimarrjen e Kuvendit.

Rekomandimet e mekanizmave ndërkombëtarëve monitorues, përmendim këtu raportin e II të raundit të IV të GRECO-s⁴, dhe rekomandimet e ekspertëve të BE-së në kuadër të zbatimit të Projektit të Binjakëzimit “*Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE*”, në kuadër të IPA 2014 për Shqipërinë⁵, zënë një vend të rëndësishëm dhe synojnë:

⁴ GRECO -Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit është strukturë e Këshillit të Europës.

⁵ Periudha e zbatimit të projektit ka qënë 12 muaj (5 Maj 2017 – 5 Maj 2018), gjatë së cilës u zbatuan 30 aktivitete, sipas 4 komponentëve të projektit.

- përmirësimin e procedurave në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së duke siguruar një kontroll më efektiv të Kuvendit në lidhje me përputhshmërinë e projektligjeve dhe një cilësi më të mirë të legjislacionit shqiptar;
- forcimin e mëtejshëm të rolit monitorues të Kuvendit;
- realizimin e pavarësisë buxhetore të Kuvendit, transparencën financiare të burimeve të financimit të Kuvendit dhe përdorimit të tyre nga deputetët;
- harmonizimin e dispozitave të Rregullores me Kodin e Sjelljes së Deputetit, me kreun e masave disiplinore dhe krijimin e mekanizmit të ankimimit ndaj masave disiplinore, që mund t'i jepen deputetit, duke zbatuar parashikimet e KEDNJ në lidhje me procesin e rregullt ligjor;
- bërjen efektive të mekanizmit të monitorimit të Kuvendit në përmbushjen e rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj (vendimi 49/2017);
- rritjen e transparencës së veprimtarisë kontrolluese të Kuvendit, veçanërisht në publikimin e pyetjeve të deputetëve dhe përgjigjeve të marra;
- rritjen e perceptimit publik për Kuvendin si një institucion plotësisht i hapur dhe transparent, i cili ofron informacionin e nevojshëm mbi rolin dhe veprimtarinë e tij në proceset zhvilluese dhe integruuese të vendit;
- monitorimin e ecurisë së procesit të integritetit evropian si dhe të raportimit në Kuvend për këtë proces, si nga Këshilli i Ministrave ashtu edhe nga institucionet e pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj etj.

VI. DREJTIMET THELBËSORE TË REFORMËS LEGJISLATIVE PROCEDURIALE DHE PUNA NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Projektvendimi i propozuar sjell mjaft risi krahasuar me rregullat aktuale të Rregullores së Kuvendit. Këto risi konsistojnë në drejtimet e mëposhtme:

1. Në lidhje me objektin e Rregullores, përdorimin e vulës, stemës dhe logos së Kuvendit

Propozohet që Rregullorja, si akti normativ bazë për punën e Kuvendit, në ushtrimin e funksionit ligjvënës, kontrollit parlamentar dhe atij zgjedhës, të ketë një nen të posaçëm që të parashikojë “Objektin” e punës së Kuvendit. Ky propozim përbën një risi dhe reflekton të gjitha aspektet që janë pjesë e Rregullores.

Gjithashtu, propozohet një rregullim i munguar për mënyrën e përdorimit të stemës, vulës dhe logos së Kuvendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Edhe ky propozim vjen si risi dhe detajon rastet e përdorimit të logos së Kuvendit në veprimtari të ndryshme si dhe për përdorim të dokumenteve zyrtare të Kuvendit.

Propozimi vjen nga shërbimet e Kuvendit dhe reflekton praktikën e huaj parlamentare. Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e këtij propozimi duke e reflektuar atë në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

2. Në lidhje me pavarësinë financiare të Kuvendit dhe Byronë e Kuvendit.

Duke qenë se Byroja e Kuvendit është organi vendimmarrës në aspektin administrativ dhe financiar për Kuvendin, propozimi sanksionon parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese për pavarësinë organizative, funksionale dhe financiare. Me këtë propozim forcohet kontrolli i financave të Kuvendit. Buxheti i Kuvendit, pas diskutimit në Byronë e Kuvendit, do t'i përcillet për shqyrtim dhe miratim Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe në vijim seancës plenare për vendimmarrje përfundimtare. Ky propozim reflekton rekomandimet e komponentit të II të IPA-s, (sipas të cilit duhet të realizohet pavarësia financiare e Kuvendit) dhe është bërë në konsensus të plotë me opozitën (ish grupin parlamentar të PD-së).

Komisioni pas shqyrtimit vendosi miratimin e këtij propozimi (sipas formulimit të deputetit B. Fino) duke e reflektuar atë në tekstin integral këtu bashkëngjitur .

Gjithashtu propozohet zgjerimi i kompetencave të Byrosë së Kuvendit. Byroja do të ushtrojë funksionet e shqyrtimit të ankesave ndaj masave disiplinore të rënda. Ky propozim vjen në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga OSBE/ODIHR gjatë konsultimit të Kodit të Sjelljes në lidhje me mekanizmin e ankimimit të masave disiplinore dhe të rekomandimit të GRECO-s. Zgjerohen aktet e miratuara nga Byroja si vijon:

- a) Raportin vjetor të veprimtarisë së Kuvendit (*kjo aktualisht e parashikuar por vendoset afati*) jo më vonë se data 31 mars të vitit pasardhës ose akte të tjera të veprimtarisë ekzekutive të Kuvendit;
- b) Raportin vjetor të pjesmarrjes së publikut në vendimmarrje, jo më vonë se data 31 Mars e vitit pasardhës;
- c) Raportin Vjetor të shkallës së zbatimit të rezolutave të Kuvendit për vlerësimin e veprimtarive të institucioneve kushtetuese dhe atyre të rregulluara me ligj të veçantë, jo më vonë se 15 muaj nga përfundimi i vitit për të cilin janë miratuar rezolutat;
- ç) Planet e veprimit ose dokumente të tjera për Kuvendin, në përmbushje të strategjive kombëtare ose rekomandimeve që burojnë nga aktet ndërkombëtare që nuk janë objekt shqyrtimi dhe miratimi në seancë plenare apo anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare;
- d) Raportin vjetor të veprimtarisë së delegacioneve të përhershme apo të përkohshme pranë organizatave ndërkombëtare;

Komisioni, pas shqyrtimit të propozimeve të mësipërme vendosi miratimin e tyre duke i reflektuar ato në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

3. Në lidhje me Sekretariatet e Kuvendit

Propozohet të krijohet Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit. Kjo është një kërkesë që i përgjigjet zhvillimeve bashkëkohore të teknologjisë dhe informacionit në funksion të rritjes së transparencës së veprimtarisë së Kuvendit. Përbërja e kësaj strukture do të jetë me 3 anëtarë (1 Sekretar dhe 2 anëtarë) dhe do të pasqyrojë përbërjen politike të Kuvendit. Ky propozim vjen nga shërbimet e Kuvendit.

Gjithashtu, *Sekretariati për Procedurat dhe Votimet* ndryshon emërtim në *Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën* dhe përbërjen nga 3 në 5 anëtarë. Ky Sekretariat do të shërbejë si shkallë e parë e dhënies së masave të rënda disiplinore, (deri më sot e ka Byroja e Kuvendit), ndërsa Byroja do të ushtrojë funksionet e shqyrtimit të ankesave ndaj masave disiplinore të rënda. Propozimi në fjalë vjen në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga OSBE/ODIHR gjatë konsultimit të Kodit të Sjelljes së Deputetit në lidhje me mekanizmin e ankimimit të masave disiplinore dhe të rekomandimit të GRECO-s.

Propozohet gjithashtu parashikimi i kompetencave kryesore të Sekretariateve (aktualisht ato parashikohen në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Sekretariateve të miratuar me vendim Byroje). Ky propozim vjen nga deputeti A. Hyseni.

Komisioni pas shqyrtimit vendosi miratimin e propozimeve të mësipërme duke i reflektuar ato në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

4. Në lidhje me Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Propozohet sa vijon:

- kjo strukturë parlamentare, në dallim nga komisionet legislative, përkufizohet si organ me funksion këshillimor që kryen funksione të vlerësimit ose të dhënies së mendimit për çështje të procedurave dhe që lidhen me funksionimin dhe vendimmarrjen e Kuvendit;
- zgjerohen kompetencat e Këshillit duke përfshirë interpretimin dhe vlerësimin periodik të Kodit të Sjelljes dhe Udhëzuesit të Detajuar për Sjelljen në Kuvend (*detyrim që buron nga Kodi i Sjelljes*), shqyrtimin e rasteve të pazgjedhshmërisë sipas nenit 69 të Kushtetutës dhe të gjitha çështjet e vlefshmërisë së mandatit të deputetit sipas nenit 70 të Kushtetutës;
- saktësohet kompetenca e këshillit në lidhje me kërkesën e Prokurorisë për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin, heqjen e lirisë në çfarëdo lloj forme, ushtrimin e kontrollit personal ose të banesës së një deputeti në përputhje me nenin 73 të Kushtetutës, duke pasqyruar në Rregullore ndryshimet kushtetuese të vitit 2012;

Në lidhje me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve propozohet sa vijon:

- mbledhja e Këshillit të bëhet edhe me kërkesë të opozitës parlamentare;
- mbledhjet të jenë të vlefshme edhe kur marrin pjesë 5 anëtarë. Ky propozim vjen për të zgjidhur ngërçin e krijuar ndër vite si rezultat i bojkotit të punimeve parlamentare nga opozita.

Duke pasur parasysh se aktualisht Këshilli mbledhet në mënyrën e parashikuar për komisionet e përhershme, pra për vlefshmërinë e mbledhjes kërkohet prania e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve, gjë që për Këshillin, për shkak të harmonizimit në mënyrë të barabartë të përbërjes (mazhorancë/opozitë) është e pamundur, propozohet vlefshmëria e mbledhjeve edhe me 5 anëtarë.

Propozimet reflektojnë ndryshimet kushtetuese të vitit 2012 lidhur me kufizimin e imunitetit të deputetit dhe përshtatjen e këtij neni me Kodin e Sjelljes së Deputetit.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimeve të mësipërme duke i reflektuar ato në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

5. Në lidhje me Këshillin për Legjislacionin

Propozohet sa vijon:

- kjo strukturë parlamentare, në dallim nga komisionet legjislative, përkufizohet si organ me funksion këshillimor, që vlerëson ose jep mendim për çështje kushtetuese ose ligjore që ngrihen në lidhje me tekstin e projektligjit dhe për çështje të harmonizimit të projektligjit me aktet e tjera ligjore në fuqi ose me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe aktet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë;
- sanksionohet parimi i kryesimit një herë nga mazhoranca një herë nga opozita.

Lidhur me çështjet organizative, edhe për këtë Këshill është propozuar të ndiqet e njëjta formulë:

- mbledhja e Këshillit të bëhet edhe me kërkesë të opozitës parlamentare;
- mbledhjet të jenë të vlefshme edhe kur marrin pjesë 5 anëtarë.

Propozimet vijnë nga grupi parlamentar i Partisë Socialiste si dhe nga praktika e deritanishme parlamentare.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimeve të mësipërme duke i reflektuar ato në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

6. Në lidhje me delegacionet e përhershme të Kuvendit pranë organizatave ndërkombëtare

Propozimi parashikon përfshirjen në Rregulloren e Kuvendit të një neni të ri për delegacionet të përhershme dhe të përkohshme si dhe detyrimin e tyre që brenda 10 ditëve nga mbarimi i veprimtarisë të paraqesin një raport për mbledhjen ose veprimtarinë në organizatën përkatëse ku merr pjesë delegacioni. Ky nen i munguar në Rregullore u vlerësua shumë i rëndësishëm për faktin e ecurisë së vendit në proceset integruuese si dhe për t'i kushtuar seriozitetin e duhur angazhimeve që duhet të përmbushë Kuvendi, në kuadër të anëtarësimit në organizmat ndërkombëtarë euroatlantike.

Propozimi vjen nga deputetja K. Bushka.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimit të mësipërm duke e reflektuar atë në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

7. Në lidhje me krijimin e grupeve parlamentare

Propozohet riformulimi i këtij neni, duke e përqasur me Kodin Zgjedhor. Riformulimet dhe shtesat bëhen me synimin që të identifikohet qartë ndryshimi i organizimit të deputetëve sipas përkatësisë partiake ose sipas orientimit politik si dhe për t'i dhënë fund fenomenit të aplikuar deri më sot të “marrjes” ose “dhënies” hua të deputetëve për krijimin e grupeve parlamentare duke parandaluar fiktivitetin e funksionimit të grupit.

Në funksion të qartësisë të deklarimit dhe pozicionit politik të grupeve parlamentare, propozohet edhe një detajim i mëtejshëm në nenin 15/1 të shtuar në këtë kre. Rregullat e nenit 15/1, kanë dalë të nevojshme, pasi shpesh ka qenë çështje diskutimi dhe analize juridike interpretimi i pozicionimit politik të një grupi, ose një deputeti. As Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, as Kuvendi as ndonjë organ tjetër nuk ka të parashikuar se ku, kur, si dhe sa herë mund të ndërrojë aleanca politike në funksion të kompozimit të blloqeve politike, të identifikueshme si “maxhorancë” nga njëra anë dhe “opozitë” nga ana tjetër.

Kodi Zgjedhor i referohet shprehjeve si “*partia më madhe e maxhorancës*”, “*partia më e madhe e opozitës*”, “*partia e dytë në maxhorancë*” “*partia e dytë në opozitë*” etj. I vetmi referim deri tani për konceptin “maxhorancë” dhe “opozitë”, është referimi i koalicioneve ose marrëveshjeve, para zgjedhore.

Rregullimi bëhet i nevojshëm për të identifikuar si pozicionimin pas zgjedhjeve të forcave politike në spektrin politik, (pasi marrëveshja parazgjedhore mund të mos reflektojë më marrëveshjen qeverisëse), ashtu edhe gjatë legjislaturës, në raste të ndryshimit të marrëveshjeve politike. Rregullimi është i domosdoshëm për të bërë transparencën e koalicioneve për efekt të qartësisë dhe për elektoratin. I njëjti arsyetim vlen edhe për deputetë të veçantë. Ky propozim vjen nga shërbimet e Kuvendit për ta përshtatur me Kodin Zgjedhor.

Lidhur me kryesinë e një grupi parlamentar janë propozuar disa saktësime dhe plotësime, të cilat i shërbejnë konstituimit të grupit si dhe përfaqësimit të tij më të plotë në raport me organizimet e strukturave të tjera drejtuese të Kuvendit. Konkretisht, propozohet që kryesia të përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe zëdhënësi. Gjithashtu, është konceptuar që grupi parlamentar të ketë një Rregullore të brendshme organizimi, si dhe vendimmarrja e grupeve të jetë e institucionalizuar. Këto propozime i japin një dimension të ri grupeve parlamentare, për vetë peshën politike që ato zenë në Kuvend.

Propozimet vijnë nga shërbimet e Kuvendit dhe i referohen praktikës së huaj parlamentare. Komisioni, pas shqyrtimit të diskutimit, vendosi miratimin e propozimeve të mësipërme duke i reflektuar ato në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

8. Në lidhje me anëtarësimin e deputetëve të pavarur dhe/ose të deputetëve jashtë grupeve parlamentare

Propozimi saktëson të drejtën e deputetëve të pavarur dhe/ose të deputetëve jashtë grupeve parlamentare për t'u anëtarësuar në strukturat e Kuvendit, konkretisht në komisionet parlamentare, nënkomisione, grupe miqësie dhe delegacione të përkohshme.

Propozimi vjen nga deputetja E. Xhina.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e tij duke e reflektuar atë në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

9. Në lidhje me kompetencat e komisioneve të përhershme të Kuvendit.

Propozohet që në nenin 19 - kompetencat e komisioneve të përhershme, të shtohet një pikë për raportin vjetor të veprimtarisë parlamentare të komisioneve të përhershme. Ky rregull përbën risi dhe do të sjellë efekte shumë pozitive në funksion të transparencës së veprimtarisë së komisioneve të përhershme parlamentare dhe evidentim të punës me analiza, shifra dhe statistika krahasuese nga viti në vit.

Propozimi vjen si rekomandim i ekspertëve të huaj të projektit IPA, komponenti IV.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e tij duke e reflektuar atë në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

10. Në lidhje me fushat e përgjegjësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit.

Propozohet të shtohet si fushë përgjegjësie për të gjitha komisionet e përhershme *“çështjet e axhendës orientuese të zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe zbatimi i angazhimeve që rrjedhin prej saj”*. Propozimi vjen nga deputetja V. Hysi dhe shërbimet e Kuvendit dhe është në përputhje me rezolutën e Kuvendit *“Për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara”*.

Njëkohësisht, në fushën e përgjegjësisë së komisionit për Integrimin Europian propozohet të shtohet edhe *“monitorimi i negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Europian”*. Ky propozim synon të forcojë rolin e Kuvendit në procesin e negociatave.

Propozimi vjen nga ekspertët e huaj të projektit IPA, komponenti II.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimeve duke i reflektuar ato në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

11. Në lidhje me Programin e Punës së Kuvendit.

Propozohet që Programi i Punës së Kuvendit të përfshijë një periudhë kohe 3-9 javë. Aktualisht është 4-12 javë. Nga praktika e tre viteve të fundit është vlerësuar se programi 6 javor që është aplikuar është një gjetje që krijon hapësira të mira për axhendën e punimeve të Kuvendit. Kohëzgjatja më e shkurtër është më efiçente, sepse i jep fleksibilitet punës së Kuvendit me projektaktet që duhet të bëhen pjesë e programit, sipas rregullit të përgjithshëm.

Gjithashtu, propozohet që nismat e deputetëve të përfshihen në kategorinë e çështjeve që hyjnë automatikisht në Programin e Punës së Kuvendit.

Propozimet vijnë nga shërbimet e Kuvendit dhe si rezultat i praktikës parlamentare.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e tij duke e reflektuar atë në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

12. Në lidhje me riprogramimin e veprimtarisë parlamentare.

Propozohet për herë të parë “*Java e dedikuar zgjedhësve*” duke kompozuar tre javë punë në Kuvend dedikuar ushtrimit të funksioneve dhe një javë dedikuar zgjedhësve ku deputetët do të zhvillojnë veprimtari njohëse me zgjedhësit.

Kuvendi, ditën e hënë që pason javën me veprimtari njohëse me zgjedhësit, do të mbledhet në seancë plenare, pasdite për diskutimin e çështjeve të adresuara nga zgjedhësit.

Ky propozim vjen nga ish grupi parlamentar i Partisë Demokratike në dakortësi me grupin parlamentar të partisë Socialiste dhe bazohet në modelin e Parlamentit Europian.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e tij duke e reflektuar atë në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

13. Në lidhje me kuorumin dhe vendimmarrjen e Kuvendit.

Propozohet të saktësohet se për përcaktimin e kuorunit në një proces votimi Kuvendi duhet t'i referohet vetëm numrit të deputetëve që kanë votuar dhe jo numrit të përgjithshëm të deputetëve që ndodhen në sallë dhe që nuk votojnë.

Çështja e përcaktimit të kuorunit të votimit dhe llogaritjes së shumicës së thjeshtë ndërlikohet në rastin e votës së pashprehur. Në këtë këndvështrim, përvoja e Kuvendit ka treguar se përcaktimi i kuorunit ka qënë problematik dhe sesi do të konsiderohen mosveprimet e deputetit, i cili është i pranishëm në sallë, por nuk shpreh asnjë vullnet. Këto çështje kanë qënë shpesh objekt debati. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se një deputet që nuk shprehet dhe që nuk ndikon aspak në procesin e votimit, nuk ka pse të llogaritet në konceptin “shumicë e të pranishmëve”. Një gjë e tillë është rritje artificiale dhe e pajustificuar e kuorunit.

Praktika parlamentare numëron jo pak raste kur deputetë qoftë të së njëjtit grupimi politik qoftë të caktuar, gjatë procesit vendimmarrës, megjithëse të pranishëm, nuk kanë votuar për çështjen objekt votimi.

Ky propozim vjen nga grupi parlamentar i Partisë Socialiste dhe reflekton vendimet e Gjykatës Kushtetuese, konkretisht vendimin nr. 29, datë 21.10.2009 me objekt: “Shfuqizimin si antikushtetues i vendimit të Kuvendit nr. 190, datë 16.06.2008 “Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e z. Z.P si anëtar i Gjykatës së lartë” dhe vendimin nr. 44, datë 7.10.2011 me objekt: “Konstatimi i papajtueshmërisë me mandatin e deputetit të zotit I.B”.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e tij duke e reflektuar atë në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

14. Në lidhje me rregullin dhe sjelljen në Kuvend.

Kreu IX “Rregulli dhe sjellja në Kuvend” është riformuluar në tërësinë e tij. Në këtë kre propozohet sa vijon:

- shtohet një masë e re disiplinore “Heqja e së drejtës së fjalës: gjatë seancës plenare ose mbledhjes së komisionit”, pasi më parë drejtuesi i seancës plenare ose i mbledhjes ka paralajmëruar deputetin;
- bëhet një klasifikim i masave disiplinore në të lehta, (të paankimueshme), dhe të rënda, (të ankimueshme);
- Sekretariati për Procedurat dhe Votimet (sipërcituar) propozohet të ketë kompetencën e shqyrtimit dhe vendimit të masave disiplinore ndaj deputetëve që çenojnë rëndë rendin dhe mbarëvajtjen e punimeve parlamentare si në seancë plenare ashtu edhe në strukturat e tjera parlamentare. Kjo strukturë, ndryshon emërtimin në “Sekretariati për Procedurat, Votimin dhe Etikën” dhe përbërjen nga 3 në 5 anëtarë duke respektuar përbërjen politike të Kuvendit (propozim i deputetit A. Hyseni);
- Parashikohet krijimi i mekanizmit të ankimimit ndaj masave disiplinore (sipërcituar) që mund t’i jepen deputetit. Kompetenca për shqyrtimin e ankesave i lihet Byrosë së Kuvendit, vendimi i së cilës do të jetë përfundimtar. Ankimimi do të bëhet vetëm për masat e rënda disiplinore. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit nga Byroja e Kuvendit do të bëhet nëpërmjet një procesi administrativ, duke respektuar parimin e procesit të rregullt ligjor;
- Zgjerohet rrethi i subjekteve që do të nënshtrohen rregullave të parashikuara në këtë kre duke përfshirë Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, anëtarët e Këshillit të Ministrave, drejtuesit/përfaqësuesit e institucioneve kushtetuese ose të krijuara me ligj si dhe persona të tjerë të pranishëm në Kuvend.
- Parashikohen masa disiplinore për rastet e moszbatimit të rregullave të parashikuara në Kodin e Sjelljes lidhur me konfliktin e interesit, dhuratat dhe lobimin në Kuvend. Me propozim të deputeteve V. Hysi dhe K. Bushka, janë bërë riformulimet përkatëse.

Ky kre, është propozuar për ndryshim nga opozita, (ish grupi parlamentar i PD), është rishikuar nga relatorja V. Hysi dhe shërbimet e Kuvendit për ta përshtatur me rekomandimet e GRECO-s dhe Kodin e Sjelljes së Deputetit. Gjithashtu, ky kre pasqyron diskutimet dhe propozimet e deputetëve në komision, duke bërë përmirësime të dispozitave përkatëse.

Komisioni, pas shqyrtimit dhe diskutimit të të propozimeve të mësipërme, bëri riformulimet e nevojshme dhe vendosi miratimin e tyre duke i reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

15. Në lidhje me organizimet vullnetare.

Deputetët e Kuvendit, prej kohësh, kanë krijuar disa organizime vullnetare jashtë angazhimeve të komisioneve ose strukturave të tjera ku bëjnë pjesë. Përmendim “Aleancën e Grave Deputete” dhe grupin “Miq të fëmijëve”, drejtuar nga Kryetari i Kuvendit, të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në procesin legjislativ e kontrollin parlamentar, edhe pse jo të parashikuar me Rregulloren. Mundësia ligjore e krijuar për regjistrimin e më shumë se 10 mijë fëmijëve në gjendjen civile, caktimi i kuotave në Kodin Zgjedhor për përfaqësimin gjinor, kontributi për përmirësimin e kuadrit ligjor për fëmijët, kanë qenë nisma të këtyre organizimeve. Tashmë, këto organizime kanë nevojë për t’u formalizuar me dispozita të veçanta në Rregulloren.

Propozimi vjen nga shërbimet e Kuvendit dhe siç u theksua edhe më lart reflekton praktikën e konsoliduar parlamentare në këtë drejtim.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e tij duke e reflektuar atë në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

16. Në lidhje me procedurën ligjvënese.

Në kuadër të procesit të konsultimit me publikun parashikohet detyrimi i Këshillit të Ministrave që në relacionin i cili shoqëron projektligjin të përfshijë edhe të dhënat për procesin në fjalë, konkretisht: personat dhe institucionet që kanë kontribuar në hartimin e projektligjit, shpjegimet në lidhje me identifikimin e grupeve të interesit, pjesëmarrësit në konsultimin publik, kohëzgjatjen e procesit të konsultimit, çështjet e diskutuara dhe opinionet e shprehura nga grupet e interesit, si dhe reflektimin ose jo në projektligj të opinioneve të grupeve të interesit.

Relacioni shoqërues gjithashtu do të përmbajë edhe çështjet dhe objektivat e axhendës orientuese të zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara si dhe zbatimin e angazhimeve që rrjedhin prej saj.

Në këtë propozim gjen reflektim Rezoluta e Kuvendit “Për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara” si dhe rekomandimet e ekspertëve të huaj të projektit të binjakëzimit (IPA), komponenti IV.

Gjithashtu, propozohet në kategorinë e projektligjeve për të cilat nuk lejohet shqyrtimi me procedurë të përshpejtuar të përfshihen edhe projektligjet që synojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së. Kjo me arsyetimin se, ndërsa procesi i integritetit evropian të Shqipërisë avancon, ngarkesa e punës së Kuvendit lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit vendas me legjislacionin e BE-së do rritet në mënyrë të konsiderueshme, dhe për pasojë projektligjeve të tilla duhet t’i kushtohet rëndësi dhe kohë e nevojshme për shqyrtim.

Gjithashtu, propozohet që amendamentet e propozuara nga Këshilli i Ministrave gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës (neni 71 i Rregullores) ose amendamentet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave në seancë plenare (neni 75 i Rregullores), të shoqërohen nga vlerësimi i përputhshmërisë së tyre me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Qëllimi i këtij propozimi është se teksti i një projektligji që synon përafrimin e legjislacionit vendas me legjislacionin e BE-së, pas miratimit të tij në Komisionin e Integritetit Evropian (KIE), i cili ka në fushën e tij të përgjegjësisë përafrimin e legjislacionit, mund të pësojë ndryshime gjatë shqyrtimit dhe miratimit të tij në komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare, ndryshime të cilat mund të jenë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së. Për rrjedhojë është e domosdoshme që të gjitha amendamentet e propozuara nga Këshilli i Ministrave t’i nënshtrohen kontrollit të përputhshmërisë së tyre me legjislacionin e BE-së.

Ky propozim vjen nga ekspertët e huaj të projektit të binjakëzimit (IPA) dhe, komponenti I dhe IV.

Komisioni pas shqyrtimit vendosi miratimin e propozimeve të mësipërme duke i reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

17. Në lidhje me reflektimin e ligjit nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit europian” në Rregulloren e Kuvendit.

Shumë prej ndryshimeve të propozuara në Rregulloren e Kuvendit janë përgatitur nga ekspertët e BE-së në kuadër të zbatimit të Projektit të Binjakëzimit “*Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE*”, në kuadër të IPA 2014 për Shqipërinë⁶.

Në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të komponentit 1 të këtij projekti⁷, ekspertët e BE-së kanë analizuar efektet e prodhuara nga ligji nr.15/2015 lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit në Kuvend, si dhe kanë paraqitur rekomandimet përkatëse ligjore për zbatimin e tij, duke përfshirë:

- i) rekomandimet ligjore për amendimin e vetë ligjit 15/2015,
- ii) rekomandimet ligjore për amendimin e Rregullos së Kuvendit me qëllim përshtatjen e saj me dispozitat e ligjit 15/2015.

Rishkimi i Rregullos së Kuvendit me qëllim përshtatjen saj me dispozitat e ligjit 15/2015 është parashikuar si masë konkrete edhe në Planin e Veprimit të Kuvendit për zbatimin Rekomandimeve të Raportit 2018 të KE-së për Shqipërinë, i miratuar me vendimin e Konferencës së Kryetarëve nr.17, datë 30.10.2018.

Përsa më sipër, reflektimi i ligjit nr. 15/2015 në dispozitat e Rregullos së Kuvendit propozohet një sërë ndryshimesh që trajtohen më poshtë.

18. Në lidhje me kontrollin parlamentar për procesin e integrimit në BE

Rëndësi të veçantë në stadin kur vendi është në pritje të çeljes së negociatave me BE-në merr edhe forcimi i kontrollit parlamentar në procesin e integrimit në Bashkimin Europian si dhe monitorimi i negociatave të anëtarësimit në të. Kuvendi do të monitorojë punën e qeverisë në lidhje me zbatimin e detyrimeve për procesin e integrimit europian dhe të institucioneve kushtetuese e të krijuara me ligj sipas detyrimit në ligjin e sipërcituar.

Në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë është parashikuar të shtohet një kre i ri, i cili i dedikohet tërësisht rolit që Kuvendi duhet të luajë gjatë negociatave të anëtarësimit, me qëllim garantimin e legjitimitetit të nevojshëm demokratik dhe kontrollin ligjor e politik të këtij procesi. Zhvillimi i negociatave të anëtarësimit i përket kryesisht përgjegjësisë së ekzekutivit, megjithatë pozicioni kombëtar i përfaqësuar nga qeveria duhet të bazohet në mbështetjen e fituar nga Kuvendi nëpërmjet ushtrimit efektiv të funksionit mbikqyrës dhe sigurimit të konsensusit të gjerë politik⁸.

⁶ Periudha e zbatimit të këtij projekti është 12 muaj (5 Maj 2017 – 5 Maj 2018), gjatë së cilës do të implementohen në total 30 aktivitete, sipas 4 komponentëve të Projektit.

⁷ Komponenti 1 “*Përmirësimi i procedurave ligjvënëse dhe i metodave të punës së Kuvendit për një proces më efektiv përafrimi të legjislacionit të BE-së*”.

⁸Kreu IV “Kontrolli parlamentar për procesin e integrimit në BE”.

Kuvendi i Shqipërisë do të luajë një rol të rëndësishëm, si gjatë negociatave ashtu edhe pas anëtarësimit në Bashkimin Europian. Gjatë negociatave të anëtarësimit, Kuvendi do të kontribuojë në proces kryesisht nëpërmjet:

- përafrimit të legjislacionit vendas me legjislacionin e BE-së;
- monitorimit dhe kontrollit të zbatimit të detyrimeve dhe reformave të ndërmarra në kuadër të anëtarësimit;
- promovimit të procesit të integrimit europian të vendit nëpërmjet bashkëpunimit ndërparlamentar dhe informimit të publikut.

Në këtë kuadër, Kuvendi ka filluar përgatitjet për të kryer në mënyrë më efektive funksionin e tij mbikqyrës ndaj ekzekutivit në funksion të hapjes dhe zhvillimit të negociatave të anëtarësimit. Ligji nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit europian” parashikon një skemë bazë të mbikqyrjes së këtij procesi, por parashikimi në Rregullore i procedurave më të formalizuara që respektojnë strukturën institucionale ekzistuese do të mundësojë krijimin e një sistemi dhe praktike të qëndrueshme të mbikqyrjes së zbatimit të detyrimeve të anëtarësimit. Për këtë qëllim, vlerësohet se parashikimi i detajuar në Rregullore i procedurave do të nxisë efektivitetin e përgjithshëm në ushtrimin e funksionit të mbikqyrjes së zhvillimit të negociatave.

Raportimi në Kuvend për procesin e integrimit në BE parashikon detajimin e hollësishëm të monitorimit të ecurisë së procesit të integrimit si dhe të raportimit në Kuvend për këtë proces, si nga ana e Këshillit të Ministrave ashtu edhe nga institucionet e pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj. Ky nen reflekton nenet 18 “Raportimi në Kuvend”, 19 “Raportimi në Komisionin për Integrimin Europian” dhe 20 “Raportimi i institucioneve të pavarura” të ligjit nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit europian”.

Propozimi vjen si rekomandim i ekspertëve të huaj të porjektit IPA, komponenti II.

Neni i shtuar, Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian (KKIE), përcakton rolin dhe përgjegjësitë e KKIE-së në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit europian” dhe Rregulloren e funksionimit të KKIE-së.

KKIE ka rolin qendror të tij në zhvillimin e dialogut civil dhe social mbi procesin e anëtarësimit të vendit në BE, në dhënien e opinionëve të specializuara, bazuar në konsensusin sa më të gjerë për këtë proces. Parashikimi në Rregullore i rolit të KKIE-së gjatë negociatave të anëtarësimit, adreson rekomandimet e Komisionit Europian në raportet vjetore për Shqipërinë⁹ sipas të cilave KKIE duhet të marrë plotësisht rolin e forumit kryesor për përfshirjen e gjerë dhe konsultimin mbi çështjet e integrimit në Bashkimin Europian.

Ky parashikim është gjithashtu një nga rekomandimet e ekspertëve të huaj të projektit të binjakëzimit të financuar nga BE, komponenti II.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e tij duke e reflektuar atë në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

⁹Raporti vjetor i Komisionit Europian për Shqipërinë viti 2016 dhe 2017.

19. Në lidhje me procesin e përafrimit të legjislacionit

Propozimet kanë për qëllim përmirësimin e dispozitave të Rregullores së Kuvendit lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së me qëllimin për të siguruar një kontroll më efektiv të përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së të projektligjeve, në të gjitha fazat e shqyrtimit të tij në Kuvend, si dhe një cilësi më të mirë të legjislacionit të përafruar. Gjithashtu ndryshimet e propozuara kanë për qëllim përshtatjen e neneve të Rregullores së Kuvendit edhe me dispozitat e ligjit nr. 15/2015 "*Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian*". Përshtatja e Rregullores së Kuvendit me ligjin 15/2015 është një detyrim që buron nga Raportet e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitet 2016¹⁰ dhe 2018¹¹.

Komisioni pas shqyrtimit vendosi miratimin e propozimeve duke i reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

20. Në lidhje me shqyrtimin ex-post të legjislacionit të përafruar me legjislacionin e BE-së¹².

Ky nen parashikon në mënyrë të detajuar procedurën që duhet të ndiqet nga Kuvendi për shqyrtimin ex-post të legjislacionit të përafruar me legjislacionin e BE-së. Në këtë proces rolin kryesor e ka Komisioni për Integritetin Europian (KIE), i cili ka në fushën e tij të përgjegjësisë përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së. KIE përzgjedh mbi bazë vjetore pjesë të legjislacionit që janë përafruar me legjislacionin e BE-së. Përzgjedhja bëhet të paktën pas 3 viteve të zbatimit të tyre. Për këtë qëllim KIE harton planin vjetor për shqyrtimin ex-post të legjislacionit të përafruar, i cili pasi konsultohet me kryetarët e komisioneve të tjera parlamentare miratohet nga Konferenca e Kryetarëve.

Plani vjetor për shqyrtimin e ex-post legjislacionit të përafruar i dërgohet ministrit përgjegjës për Marrëdhëniet me Kuvendin dhe ministrive përgjegjëse. Këto të fundit përgatisin dhe dërgojnë në Kuvend, në komisionet e përhershme, raportin për zbatimin e legjislacionit i cili do të përmbajë: një vlerësim paraprak të kornizës ligjore që do të shqyrtohet; një analizë për shkallën e zbatueshmërisë së legjislacionit të përafruar; një përshkrim të shkurtër të legjislacionit përkatës të deleguar dhe çdo dokument tjetër vlerësimi që ministria përgjegjëse mban për këtë qëllim. Komisionet e përhershme hartojnë raportin e tyre për shqyrtimin e legjislacionit ex-post. Komisionet mund të bëjnë konsultime publike, seanca dëgjimore me grupet e interesuara dhe të përdorin çdo material tjetër, si: vlerësimi mbi ndikimin e legjislacionit; vendime të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; vendime të gjykatave kombëtare; opinione, deklarata/qëndrime, raporte të institucioneve të BE-së; raporte kombëtare nga shtetet anëtare për zbatimin praktik të kornizave të BE-së, ose literaturë akademike. Raporti i shqyrtimit ex-post i dorëzohet Komisionit për Integritetin Europian i cili në bashkëpunim me komisionin e përhershëm diskutojnë mbi raportin dhe më pas ia referojnë seancës plenare.

¹⁰Raporti i vitit 2016 rekomandon: "*Rregullorja parlamentare duhet të reflektojë ligjin për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit në BE, i miratuar në mars 2015*" (fq.7 e Raportit).

¹¹ Raporti i vitit 2018 rekomandon: "*Rregullorja e Kuvendit duhet të pasqyrojë ligjin mbi rolin e Kuvendit në procesin e integritetit në BE, të miratuar në mars të vitit 2015*" (fq. 9 e Raportit).

Propozimi vjen si rekomandim i ekspertëve të huaj të projektit IPA, komponenti II. Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimeve duke i reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

21. Në lidhje me Planin e Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të BE-së.

Ky propozim rregullon një praktikë të konsoliduar, e cila është krijuar në Kuvend që prej vitit 2013. Me qëllim zbatimin sa më korrekt të rekomandimeve të përcaktuara për Kuvendin në raportet vjetore të Komisionit European (KE) për Shqipërinë, prej vitit 2013 dhe në vijim, Kuvendi i Shqipërisë ka hartuar dhe miratuar “Planin e Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit European për Shqipërinë”. Ky plan vjetor pasqyron gjetjet, rekomandimet dhe sfidat e identifikuara në raport dhe zbërthen në masa konkrete secilin nga rekomandimet e dhëna, duke përcaktuar strukturën përgjegjëse në Kuvend si dhe afatin kohor të parashikuar për adresimin dhe zbatimin e tij. Ky dokument mundëson planifikimin dhe monitorimin periodik nga ana e Kuvendit të zbatimit të rekomandimeve të përcaktuara nga Komisioni European me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të funksionimit të tij në linjë me standartet europiane.

Propozimi vjen nga shërbimet e Kuvendit si rezultat i praktikës tashmë të konsoliduar parlamentare në këtë drejtim.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimit duke e reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

22. Në lidhje me kohën e diskutimeve në seanca plenare

Propozohet që të shfuqizohet dyfishimi i kohës prej 20 minutash kur diskutohen çështje si programi politik, mocione besimi, mosbesimi, projektligje me shumicë të cilësuar, ratifikime të marrëveshjeve etj. Kjo pikë është një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i diskutimit të çështjeve me 10 minuta. Hierarkia e akteve nuk duhet që të nënkuptojë edhe hierarki në caktimin e kohës për diskutim. Nëse do t’i referohemi praktikës së Parlamentit European (PE) apo të mjaft parlamenteve të tjera të BE-së, tendenca është për të ulur minutazhin e diskutimit dhe për ta bërë atë sa më eficient. Aktualisht ajo është 7 minuta në PE dhe varion nga 5-7-10 minuta në vendet e tjera.

Propozimi vjen nga grupi parlamentar i partisë Socialiste në dakortësi me opozitën (ish grupin parlamentar të PD) dhe i referohet praktikës së huaj parlamentare.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimit duke e reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

23. Në lidhje me nocionin e veprimtarisë parlamentare.

Propozimi konsiston në kuptimin që i jepet nocionit të veprimtarisë parlamentare duke konsideruar si veprimtari të tillë edhe veprimtarinë e deputetit në zonat zgjedhore.

Ky propozim vjen nga deputeti A. Hyseni dhe shërbimet e Kuvendit.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimit duke e reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

24. Në lidhje me instrumentet e kontrollit parlamentar.

Propozohen një sërë formulimesh për nenet e kontrollit parlamentar. Propozimet i shërbejnë rritjes së transparencës së veprimtarisë kontrolluese të Kuvendit, veçanërisht publikimit në faqen e Kuvendit të pyetjeve të bëra në seancë dhe në komisione, si dhe përgjigjet e tyre. Propozime të tjera vijnë edhe në kuadër të rritjes së perceptimit publik për Kuvendin si një institucion plotësisht i hapur dhe transparent, i cili ofron informacionin e nevojshëm mbi rolin dhe veprimtarinë e tij në proceset zhvilluese dhe integruese të vendit (publikimi i pyetjeve të deputetëve drejtuar anëtarëve të Këshillit të Ministrave si dhe përgjigjet e dhëna, planet e veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të ndërkombëtarëve etj).

Këto propozime vijnë nga ekspertët e huaj të projektit IPA, komponenti II.

Në kuadër të kontrollit parlamentar nga komisionet e përhershme të Kuvendit, propozohet detyrimi i drejtuesve të institucioneve shtetërore të japin shpjegime dhe informojnë Kuvendin jo vetëm për çështje që lidhen me veprimtarinë e tyre por edhe për çështje që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura të adresuara kundrejt tyre. Ky propozim përqa zbatimin e mekanizmit të monitorimit të Kuvendit për përmbushjen e rekomandimeve të institucioneve të pavarura me Rregulloren e Kuvendit. Propozimi vjen nga shërbimet e Kuvendit dhe synon ta bëjë më detyruese llogaridhënien e ekzekutivit në raport me rekomandimet e institucioneve të pavarura.

Gjithashtu propozohet miratimi i kalendareve 1 apo 2 javore nga ana e komisioneve të përhershme të Kuvendit për çështje të kontrollit parlamentar.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimeve duke i reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

25. Në lidhje me votimin e fshehtë

Propozim tjetër që lidhet ngushtë me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 (reforma në drejtësi) është edhe shfuqizimi i pikës 1/1 të nenit 60 sipas të cilit *“Në rastin e dhënies së pëlqimit të Kuvendit për dekretet e Presidentit të Republikës për emërim në Gjykatën Kushtetuese ose në Gjykatën e Lartë votimi është nominal”*.

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, lidhur me reformën në drejtësi, anëtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti me propozim të Këshillit të lartë Gjyqësor ndërsa anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, konkretisht vetëm tre prej tyre, përzgjidhen nga Kuvendi ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Pra, Kuvendi nuk është më palë në emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Termi *“pëlqim”* që gjendej më parë në dispozitat kushtetuese tashmë nuk ekziston me ndryshimet e reja kushtetuese.

Tre anëtarët e Gjykatës Kushtetuese do t'i nënshtrohen votimit të fshehtë si të gjitha kandidaturat që paraqiten për t'u zgjedhur nga Kuvendi. Për më tepër që pika 1 e nenit 60 parashikon se votimi i fshehtë bëhet për çështje që kanë të bëjnë me personat.

Propozohet gjithashtu riformulimi i pikës 4 të këtij neni duke iu referuar standardit të fletës së votimit ashtu siç e përcakton Kodi Zgjedhor.

Propozimet vijnë nga shërbimet e Kuvendit dhe reflektojnë ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 si dhe Kodin zgjedhor.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimeve duke i reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

26. Në lidhje me procedurën e ndjekur nga Kuvendi në rastet e kërkesës së prokurorit për dhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrollit personal ose të banesës.

Ndryshimet kushtetuese të vitit 2012 reformuan plotësisht sistemin e imuniteteve të parashikuara në Kushtetutë për t'i sjellë ato në përputhje me standartet ndërkombëtare në këtë fushë. Ato kufizuan imunitetin e deputetit duke lejuar organet e drejtësisë që të ushtrojnë funksionet e tyre edhe ndaj personave me imunitet.

Dispozitat kushtetuese për kufizimin e imunitetit të deputetit dhe procedura e ndjekur në rastin e kërimit të autorizimit nga Kuvendi për caktimin e masës së sigurimit u reflektuan edhe në Kodin e Procedurës Penale të miratuar me ligjin nr 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës penale të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar"". Nenet 288 dhe 289 të Kodit parashikojnë autorizimin nga Kuvendi kur ndaj një deputeti duhet të caktohet masa e sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqja e lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrolli personal ose i banesës. Kërkesa për autorizim nga Kuvendi shoqërohet me një relacion të arsyetuar, të shoqëruar me provat që mbështesin kërkesën.

Duke pasur parasysh ndryshimet kushtetuese dhe ato të Kodit të Procedurës Penale lindi si domosdoshmëri ndryshimi i nenit 118 dhe nenit 119 në Rregulloren e Kuvendit.

Grupi parlamentar i partisë Socialiste, si nismëtar i propozimeve për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit, kishte propozuar riformulimin e neneve lidhur me imunitetin, duke i sjellë ato në shtratin kushtetues dhe të Kodit të Procedurave Penale por për shkak të kundërshtimit nga ana e opozitës së asaj kohe (ish grupit parlamentar të PD dhe LSI) riformulimet u tërhoqën. Opozitës iu kërkua që riformulimet e "imunitetit" të kishin autorësinë e saj.

Duke qënë se opozita parlamentare më datë 21.02.2019 hoqi dorë nga mandati dhe se dispozitat kushtetuese ishin të detyrueshme për tu reflektuar në Rregulloren e Kuvendit, komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me iniciativën e tij mori nismën për të amenduar nenet 118 dhe 119 të Rregullores.

Propozimet konsistojnë në këto drejtime:

- Titulli i nenit bëhet “Dhënia e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, për kontrollin personal ose të banesës”;
- Subjekti i cili ka kompetencën për t’i paraqitur Kuvendit kërkesën për dhënien e autorizimit:

Aktualisht parashikohet prokurori i Përgjithshëm. Në reflektim të ndryshimeve kushtetuese kërkesa paraqitet nga Prokurori i çështjes. Në rastet kur deputeti kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë ai mund të ndalohej ose të arrestohet, por prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin. Deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim për veprat penale apo subjektet e parashikuara në nenin 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të hetohen përkatësisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, sipas kompetencës.

- Saktësohet forma e hapur e votimit në pajtim me nenin 73 të Kushtetutës, pasi neni 118 i Rregullores, aktualisht parashikon formën e mbyllur të votimit.

Komisioni, pas diskutimeve, vendosi riformulimin e propozimeve dhe i reflektoi ato në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

27. Në lidhje me raportin e komisionit hetimor në rastet e kërkesave për shkarkim të anëtarit të organit kushtetues

Propozimi për ndryshimin e pikës 3 të nenit 114 synon të saktësojë qartë procedurën e votimit në Kuvend të kërkesës për shkarkim të anëtarit të organit kushtetues. Propozimi i paraqitur rikthen votimin e fshehtë duke e lidhur kërkesën për shkarkim me personin dhe jo me raportin e komisionit hetimor.

Aktualisht me ndryshimet e fundit kushtetuese numri i titullarëve të organeve kushtetuese që shkarkohen nga Kuvendi është kufizuar ndjeshëm. Kuvendi shkarkon Presidentin e Republikës, Avokatin e Popullit, kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e organit kushtetues i dërgohet Gjykatës Kushtetuese vetëm në rastin e shkarkimit të Presidentit të Republikës dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky propozim vjen nga shërbimet e Kuvendit në reflektim të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 për reformën në drejtësi.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimit duke e reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

28. Në lidhje me procedurën e konstatimit të kufizimeve të deputetit gjatë ushtrimit të mandatit

Propozohet që kufizimet për deputetin në ushtrim të mandatit të tij të fillojnë ditën që deputeti shpallet i zgjedhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ose në rast ankimi, nga gjykata kompetente. Nga ky moment deputeti është i detyruar të plotësojë të gjitha kërkesat kushtetuese

dhe ligjore që lidhen me ndalimin e kryerjes së aktiviteteve të tjera ose deklaratimet lidhur me interesat e tij financiarë siç parashikon Kushtetuta në nenin 70 të saj dhe ligjet e tjera përkatëse. Deputeti merr të gjitha masat për të shmangur çdo situatë papajtueshmërie ose konflikti interesi që mund të lindë në momentin e fillimit të mandatit parlamentar dhe gjatë gjithë kohës që ai vazhdon. Deputeti ndërmerr veprimet konkrete jo më vonë se momenti i shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, kohë në të cilën mundësohet siguria dhe qartësia te deputeti për të ardhurat e tij financiare.

Ky propozim vjen nga opozita, (ish grupi parlamentar i PD-së) dhe reflekton vendimin nr. 44, datë 7.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese me objekt: “Konstatimi i papajtueshmërisë me mandatin e deputetit të zotit I.B”.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimit duke e reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

29. Në lidhje me llogaritjen e afateve që parashikon Rregullorja e Kuvendit

Propozimi konsiston në mënyrën e llogaritjes së afateve që parashikon Rregullorja duke e përshtatur me Kodin e Procedurave Administrative.

Propozimi vjen nga shërbimet e Kuvendit. Komisioni pas shqyrtimit vendosi miratimin e propozimit duke e reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

30. Në lidhje me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Propozohet që neni të riformulohet, duke u fokusuar tek vendimet e Gjykatës Kushtetuese të mëposhtme:

- a) vlerësimin e kushtetutshmërisë së legjislacionit që ka nismëtarë deputetin/deputetët;
- b) interpretimin përfundimtar të Kushtetutës;
- c) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës, kur Kuvendi është palë;
- ç) shkarkimin e funksionarëve kushtetues, të cilët zgjidhen nga Kuvendi;
- d) rastet kur kërkesa në Gjykatë Kushtetuese është paraqitur nga jo më pak se 1/5 e deputetëve.

Pra, zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese do të fokusohet kryesisht mbi aktet e Kuvendit si dhe ligjet që janë me nismë ligjvënëse nga deputetët. Ky riformulim del i nevojshëm për shkak të moszbatimit të nenit aktual, si pasojë e formulimit të tij evaziv.

Propozimi vjen nga shërbimet e Kuvendit dhe reflekton praktikën parlamentare.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimit duke e reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

31. Në lidhje me procedurën paraprake të përzgjedhjes të kandidatëve në organet kushtetuese apo të krijuara me ligj

Propozohet që kandidaturat për në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, të cilat zgjidhen nga Kuvendi, t'i nënshtrohen një procedure paraprake përzgjedhjeje. Këtë lloj procedure Kuvendi tashmë ka vite që e aplikon duke e kthyer atë në një praktikë të konsoliduar parlamentare. Procedura paraprake e përzgjedhjes ndjek fazat e mëposhtme:

a) Kuvendi bën shpalljen dhe publikimin e vakancës së organit të krijuar me ligj nga Kuvendi në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik, për një afat prej 20 ditësh nga publikimi;

b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, lista me kandidaturat e vet ofruara u bëhet e njohur anëtarëve të Kuvendit;

c) Brenda 5 ditëve nga dërgimi i njoftimit të listës së kandidaturave të vetofruara tek grupet parlamentare, organizohet dëgjesa e hapur publike në mjediset e Kuvendit ku njoftohen të marrin pjesë të gjithë deputetët/grupet parlamentare;

ç) Pas dëgjesës publike, të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin/kandidatët, që do të mbështesin për t'ia propozuar Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit;

d) Kandidaturat që marrin mbështetjen me firma të jo më pak se 28 deputetëve, depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe vazhdojnë procedurat e parashikuara në këtë nen.

Parashikimi në Rregullore i këtij procesi do të unifikojë procedurën për të gjitha rastet e zgjedhjes/emërimit për vakancat e krijuara, duke shmangur miratim vendimesh rast pas rasti. Propozimi vjen nga shërbimet e Kuvendit dhe i referohet (siç u sipërcitua) praktikës së konsoliduar parlamentare.

Komisioni, pas shqyrtimit e diskutimit, vendosi miratimin e propozimit duke e reflektuar në tekstin integral këtu bashkëngjitur.

VII. DREJTIME TË TJERA TË REFORMËS LEGJISLATIVE PROCEDURIALE DHE PUNA NË KOMISIONIN E ÇËSHTJEVE LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Drejtime të tjera të reformës legjislativë proceduriale, që u shqyrtuan dhe miratuan në Komisionin e Ligjeve, sipas propozimeve respektive, konsistojnë si më poshtë:

- *Parashikohet e drejta e komisioneve parlamentare dhe nënkomisioneve për të zhvilluar mbledhje edhe jashtë selisë së Kuvendit. Vendimi për këtë i takon kryesisë së komisionit. Për mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare jashtë selisë vendimin e merr Konferenca e Kryetarëve (nen i munguar);*
- *Anëtarësia e deputetëve në grupet e miqësisë me parlamentet e vendeve të tjera propozohet të bëhet nga Kryetari i Kuvendit në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare (rregullim i munguar);*
- *Kërkesat e deputetëve për të mbajtur 1 minutë heshtje solemne në seancë plenare shqyrtohen dhe vendosen nga Kryetari i Kuvendit në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare (rregullim i munguar);*
- *Në mbledhjet e Konferencës së Kryetarëve në mungesë të kryetarëve të komisioneve të përhershme apo grupeve parlamentare propozohet të marrin pjesë zëvendëskryetarët e tyre (rregullim i munguar);*
- *Anëtarësia në nënkomisionet parlamentare propozohet të variojë nga 5 deri në 9 anëtarë dhe jo detyrimisht të jetë e lidhur me anëtarësinë e komisionit të përhershëm brenda të cilit ngrihet (rregullim i munguar);*

- Anëtarët e komisionit për Integrimin European propozohen të jenë anëtarë edhe në komisionet e tjera të përhershme (rregullim i munguar);
- Propozohet të caktohen anëtarë zëvendësues edhe në strukturat parlamentare si: komisionet hetimore, të posaçme, nënkomisionet dhe këshillat; për të qënë në të njëjtën linjë me komisionet e përhershme (rregullim i munguar);
- Propozohet që shtyrja e afatit të veprimtarisë së komisionit të posaçëm dhe hetimor të bëhet me kërkesë të arsyetuar dhe vendim të ndërmjetëm të komisionit. Kur veprimtaria e komisionit të posaçëm ka për objekt hartimin e nismave ligjvënëse, kjo e fundit propozohet të futet për shqyrtim në seancë plenare jo më parë se një javë nga depozitimi;
- Propozohet që të ketë një nen për rendin e ditës të seancës plenare dhe që të përmbajë çështjet e parashikuara në kalendarin tre javor, shqyrtimi i të cilave në komisionet parlamentare të ketë përfunduar (rregullim i munguar);
- Propozohet pezullimi i mbledhjes së komisionit në rast se cënohet seriozisht rendi i punimeve, shkaktohet kaos dhe nuk merren parasysh kërkesat e drejtuesit të mbledhjes, si dhe detyrimi për të votuar propozimin për pezullim (deputetja E. Bode);
- Propozohet të saktësohen rastet se kur votimi i hapur është detyrues;
- Konstatimi i faturës financiare për projektligjet joqeritare i lihet komisionit përgjegjës;
- Propozohet që shqyrtimi i projektligjeve nuk mund të fillojë pa kaluar të paktën dy javë nga depozitimi në Kuvend;
- Raporti i komisionit përgjegjës dhe komisionit për dhënie mendimi propozohet të hartohen jo më vonë se 4 ditë nga përfundimi i shqyrtimit të çështjes. Shumëfishimi i tyre propozohet të bëhet të paktën 1 javë përpara datës së shqyrtimit të projektligjit në seancë plenare;
- Dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim propozohet të shqyrtohet në mbledhjen më të parë të komisionit përgjegjës; Shqyrtimi në seancë plenare të bëhet jo më parë se 48 orë;
- Projektaktet e depozituara për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, të cilat pas mbylljes së legjislaturës kanë mbetur ende në procedurë propozohet t'i kthehen nismëtarit (rregullim i munguar);
- Propozohet të parashikohet me Rregulloren e Kuvendit detyra kryesore e Shërbimit të Sigurisë lidhur me kontrollin e hyrje-daljeve të të gjithë personave në mjediset e Kuvendit, duke përfshirë një kategori të caktuar funksionarësh si Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese etj.

Komisioni pas shqyrtimit e diskutimit të të gjitha propozimeve të sipërpërmendura vendosi, miratimin e tyre duke i reflektuar ato në tekstin integral këtu bashkëngjitur me formulimet përkatëse.

VIII. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se :

- Në aspektin ligjor, projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektvendimi është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

Përsa më sipër, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pasi e shqyrtoi projektvendimin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, sipas tekstit integral bashkëlidhur, i cili i përcillet për votim seancës plenare.

RELATORE

KRYETAR

VASILIKA HYSI

ULSI MANJA